

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Hetimet - Gjyqi ndaj ish-krerëve të UÇK-së/ Reuters: Vendimi mund të tronditë raportet e Kosovës me P erëndimin
ADRESA	https://www.syri.net/politike/916688/gjyqi-ndaj-ish-krereve-te-uck-se-reuters-vendimi-mund-te-trondite-raportet-e-kosoves-me-perendimin/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 20:38:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 20:01:58 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	af3d15d30a521f9f42c28bf51f093b13014cc6b37b050bcd50db9173d2de32cb
TEKSTI	986162f20c47a07be51d4b7bd818ca332a9f2f563777c2214324afb26476f789
PAMJA	86882341e7db711fcc422d7ca495172e1824274aed8e932c69edea30a083edf3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bbc80466ebfecf90c4903cea7aeab23bca1fa038026500c64a0bf413705cc500
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	14f4bd53e2e66d8385ba6de2378a49e0445f54add9285267e471b01ae86271f6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bbc80466ebfecf90c4903cea7aeab23bca1fa038026500c64a0bf413705cc500>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**IRENA BEQIRAJ**

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

**AGIM XHAFKA**

Dialog me mbesën



më të lexuarat

Modeli Kayo, Bozdo: Janë krijuar 20 kompani, kanë marrë monopolin në disa fusha


Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin

'Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama', Kepi: E kanë të lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre

Berisha në Konventën Republikane në Dallas - Takime me drejtues të Departamentit të Drejtësisë, Takime me senatore

Shqiptari nga Anglia: Rama dha urdhër të mos hyjmë në shesh! Të rimë këtu derisa ta shporrim nga zyra antishqiptarin

Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhduket historia



Gjyqi ndaj ish-krerëve të UÇK-së/ Reuters: Vendimi mund të tronditë raportet e Kosovës me Perëndimin

22:01, 14/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Dhomat e Specializuara të Kosovës pritet të shpallin të mërkurën aktgjykimin në procesin ndaj ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, dhe tre ish-komandantëve të tjerë të lartë të UÇK-së.

Prokuroria ka kërkuar nga 45 vjet burg për Thaçin, 58 vjeç, dhe tre ish-komandantët, të cilët akuzohen për një sërë krimesh të kryera gjatë dhe pas luftës së viteve 1998-1999. Të akuzuarit i mohojnë të gjitha akuzat, ndërsa mbrojtja ka kërkuar shpalljen e pafajësisë.

Në qytete të ndryshme të Kosovës janë vendosur ekrane të mëdha me numërimin mbrapsht deri në shpalljen e vendimit, i cili në Hagë pritet të nisë në orën 10:00. Të shtunën, mijëra qytetarë morën pjesë në një tubim në Prishtinë, duke kërkuar lirin e ish-krerëve të UÇK-së.

Thaçi dhe tre ish-komandantët akuzohen për përndjekje, vrasje, torturë dhe zhdukje të detyruar të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës gjatë dhe menjëherë pas luftës. Prokuroria pretendon se më shumë se 100 kundërshtarë politikë dhe persona të perceptuar si bashkëpunëtorë të forcave serbe janë vrarë gjatë kësaj periudhe.

Avokatët e Thaçit kanë argumentuar se akuzat janë të pabazuara dhe se nuk ka prova që e lidhin drejtpërdrejt atë me krimet e pretenduara apo që dëshmojnë se ai kishte kontroll mbi komandantët e tjerë të UÇK-së.

Procesi është ndjekur me vëmendje të madhe në Kosovë, ku Dhomat e Specializuara, të përbëra nga gjyqtarë dhe juristë ndërkombëtarë, mbeten një institucion i kontestuar. Për shkak të frikësimit të dëshmitarëve, një pjesë e dëshmimeve të prokurorisë janë zhvilluar me dyer të mbyllura, duke shtuar edhe më tej mosbesimin ndaj gjykatës.

Sipas analistëve të cituar nga Reuters, vendimi mund të ketë pasoja të rëndësishme politike për Kosovën, veçanërisht në marrëdhëniet me Shtetet e

Bashkuara dhe vendet e tjera perëndimore. Një vendim në favor të Thaçit mund të ndikojë në ekuilibrat politikë në Kosovë dhe të forcojë bashkëpunimin me Perëndimin, ndërsa një dënim mund të thellojë distancën e krijuar vitet e fundit.

"Vendimi është një ngjarje tektonike", tha Agon Maliqi, bashkëpunëtor i lartë jorezident në Qendrën për Europën të Atlantic Council.

Sipas tij, rezultati mund të ndikojë edhe në marrëdhëniet ndëretnike brenda Kosovës dhe në raportet me Serbinë. Reagimet ndaj vendimit pritet të jenë të forta, ndërsa ekziston rreziku që aktorë të ndryshëm të përipiqen të shfrytëzojnë situatën për të nxitur tensione.

Thaçi ishte president i Kosovës nga viti 2016 deri në vitin 2020 dhe kryeministër nga viti 2008 deri në vitin 2014. Edhe në rast se shpallet i pafajshëm në çështjen kryesore, ai mund të mos lirohet menjëherë, pasi prokuroria ka kërkuar gjashtë vjet burg ndaj tij në një proces të veçantë për ndërhyrje të dyshuar te dëshmitarët. Thaçi i mohon edhe këto akuza.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Rama çan me thonj pasagjerin, reagon Berisha: Dënoj me forcën më të madhe dhunën brutale të Padrinos



VIDEO-Përgjimi i Roni Yeffet/ Abilekaj: Flet për armë nga Sudani, kjo i heq licencën. Ku shkuan 30 mln euro?



Bardhi reagon për përgjimet e reja të Ron Yeffet: Kjo histori kërkon transparencë, hetim dhe përgjegjësi. Menjëherë...

'Po blejnë influencë te zyrtarët e BE', Xhaferri: Rama i mori 17 miliardë lekë Universitetit të Tiranës për Kolegjin e Evropës

SYRI TV/ Karakaçi: TEC-et do jenë pronë e KESH, ERE ka shtyrë licencimin e tyre

'Diaspora nuk ka për t'ia falur Ramës! Shqiptarët e bashkuar pushteti i tmerruar! Dita e 105 e protestës në foto

TË NGJASHME



'Rama ka ndërtuar gjithçka', Saraçi: Përgjimi lidh Ballukun me skemën e Timak Defense



VIDEO-Delvina Gas/ Yeffet instruktin ukrainasit dhe rusët: Shkoni në Vlorë dhe thoni se përfaqësoni një kompani amerikane



VIDEO/ Hoxha: Balluku shkoi vetë te Delvina Gas me gjithë kupolën e institucioneve dhe udhëhoqi aksionin e bllokimit



'Divjaka e qytetarëve, jo e tradhtarëve!'/ Banorët vijojnë protestën e 46-të kundër shkrirjes së bashkisë



Skandali 'KAYO', Hoxhaj: U dhanë 30 milionë euro nga buxheti i shtetit për makina të salduara në një kabanon



VIDEO-'Ministrinë e Energjetikës ma lini mua'/ Përgjimi skandaloz i Roni Yeffet: Mos nisni asnjë letër zyrtare, merrem unë me ta



'Rama jepe dorëheqjen!'/ Përfundojnë fjalimet, protestuesit rinisin marshimin

LAJME POLITIKE KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MEDIËS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net